

**FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS**  
**PRISHTINË**

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**  
**DHE PASQYRAT FINANCIARE**

**Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019**

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019

Përmbajtja

Raporti i auditorit të Pavarur.....	3-4
Bilanci gjendjes.....	5
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse.....	6
Ndryshimet në ekuitet.....	7
Rjedhja e paras.....	8
Shenime mbi subjektin.....	9
Shënime shpjeguese ne Pasqyrat Financiare.....	10-17

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menagjmentin e Shoqatës joqeveritare: FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS - Prishtinë

### Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Federata Aeronautike e Kosovës, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

### Përgjegjsia e menagjmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të Pasqyrave Financiare në përputhje me SNRF për NVM ,dhe për ato kontrole të brendëshme që menagjmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale ,qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e Pasqyrave Financiare ,menagjmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi ,për të dhënë informacion ,nëse është e zbatueshme ,për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menagjmenti synon ta likuidojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet , nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

### Përgjegjësit e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse Pasqyrat Financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit , dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë .Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë , por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston .Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse ,individualisht ose të marra së bashku,pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA –të ,ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit . Ne gjithashtu:

## FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë material ,qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit,hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve ,dhe marrim evidence auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tone. Rreziku I mos zbulimit të një anomalie material si rezultat I mashtrimit është më I lartë se rreziku si rezultat I gabimit,sepse mashtrimi mund të përfshijë marrveshje të fshehta ,falsifikime,përrjashtime të qëllimshme,informacione të deformuara ,anashkalime të kontrolleve të brendshme.

Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të pëcaktuojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave ,por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve Kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

-Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri material në lidhje me ngjarjet ose kushtet ,e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditusit në lidhje me shpjegimet e dhëna në Pasqyra Financiare ,ose nëse këto shpjegime janë të përshtatshme , duhet të modifikojmë opinionin tone. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit

Megjithatë ,ngjarjet ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithëshme ,strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen ,përveç të tjerave,lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit ,përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

### Përfundimi

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Federatës Aeronautike të Kosovës (FAK) të financuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) të Kosovës për projektet e implementuara sipas politikave programore të Ministris në fushë të sportit , paraqesin gjendjen reale e të drejtë ,në të gjitha aspektet materiale, të hyrat e pranuar dhe pagesat e ndodhura për periudhën janar – dhjetor 2019, në përputhje me Memorandumin e Bashkupimit të lidhur ndërmjet Federatës Aeronautike të Kosovës (FAK) dhe Ministrisë Kulturës ,Rinisë dhe Sportit (MKRS).

Ky raport është I dedikuar vetëm për informimin dhe përdorimin e këtyre informative nga Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe për qëllime të tjera nuk mund të përdoret.

Farije Kabashi Bellanica - Auditore Ligjore

Prizren : 23.04.2020

FARUJE KABASHI BELLANICA  
AUDITORE LIGJORE  
Tel. 044/8000000 Prizren

**FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS**  
**Paqyra e pozitës financiare**  
**Më 31.12.2019**

<b>PASURITË</b>	<b>Shënimi</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Pasuritë afatshkurtra		<b>€</b>	<b>€</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	1,278	339
Investimet financiare afatshkurtra	7	-	5,891
Të arktueshme afatshkurtra nga grantet	6	18,564	-
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	915	-
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>20,757</b>	<b>6,230</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>20,757</b>	<b>6,230</b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	12,476	-
Detyrimet e tjera afatshkurtra /huat /	9	2,035	5,000
Detyrimet e tatimeve	9	502	-
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>15,012</b>	<b>5,000</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>15,012</b>	<b>5,000</b>
<b>EKUITETI</b>			
Fitimet e mbajtura		1,230	-
Fitimi (humbja) e vitit	14	4,515	1,230
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>5,745</b>	<b>1,230</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>20,757</b>	<b>6,230</b>

*Drejtori i përgjithshëm*

Drejtori financiar

FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS

Paqyra e të ardhurave gjithëpërshirëse për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

	Shënimi	2019 €	2018 €
Të hyrat	10	42,818	35,155
<b>Fitimi / (humbja) bruto</b>		<b>42,818</b>	<b>35,155</b>
Shpenzimet administrative	11	1,000	5,249
Shpenzimet programore dhe donacionet	12	36,417	28,393
Shpenzimet tjera	13	384	283
<b>Fitimi / (humbja) operativ</b>		<b>5,017</b>	<b>1,230</b>
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>5,017</b>	<b>1,230</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	14	502	-
<b>Fitimi / (humbja) i/e vitit</b>		<b>4,515</b>	<b>1,230</b>

FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS

Paqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

	Kapitali I pronarit	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>		-	-	-
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	1,230	-	1,230
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	-	1,230	-	1,230
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	4,515	-	4,515
Terheqjet		-		-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	-	5,745	-	5,745

**FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS**  
**Paqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

	Shënimi	2019 €	2018 €
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		4,515	1,230
		<u>4,515</u>	<u>1,230</u>
<b>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</b>			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të Tjera		(915)	-
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera		(12,674)	32,798
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		12,476	-
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		502	(34,540)
		<u>(611)</u>	<u>(1,742)</u>
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>		<u>3,904</u>	<u>(512)</u>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>			
Terheqjet		-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		(2,965)	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>		<u>(2,965)</u>	<u>-</u>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>		939	(512)
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>		939	(512)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		339	851
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	4	<u>1,278</u>	<u>339</u>

**I. SHËNIME MBI SUBJEKTIN**

Federata Aeronautike e Kosovës aktivitetin e ushtron që nga viti 2000, me numër të regjistrimit 51004118 dhe me numër fiskal 600388848, me adresë Rr. Agim Ramadani Prishtinë.

Federata Aeronautike e Kosovës gjatë vitit 2019 ka lidhur një memorandum bashkëpunimi me Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për mbështetje financiare në realizimin e objektivave dhe synimeve të saj rrjedhimisht duke zbatuar politikat programore të Ministrisë në fushë të sportit dhe në pajtim me dispozitat e ligjit për sport dhe aktivitete nënligjore të përcaktuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në përmbushjen e programit sportive të Federatës Aeronautike Kosovës ka pas mbështetje edhe nga ndonjë sponsor por edhe të hyra nga aktivitetet sportive.

Veprimtaria kryesore e Federatës Aeronautike e Kosovës është organizimi dhe pjesmarrja e aktivistëve dhe sportistëve nga klubet e Kosovës në fushën e aeronautikës, në gara lokale dhe ndërkombëtare, të cilat organizohen çdo vitë.

Federata Aeronautike e Kosovës përbëhet nga pesëmbdhjetë klube në mbarë territorin e Kosovës. Kjo federate numëron me mbi dyqind anëtarë të cilët merren me veprimtari të ndryshme sportive ajrore. Përparsi të veçantë kanë gjinia femërore dhe grupet tjera etnike. Kohët e fundit është bashkëngjitur edhe aeroklubi nga Leposaviqi.

## **2 Politika kontabël**

Politikat kontabël të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është e theksuar ndryshe.

### **2.1 Baza e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM) të aprovuara nga Këshilli Kosovar mbi Raportimin Financiar (KKRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historike dhe bazuar mbi parimin e vijimësisë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet e shënuara më sipër kërkon nga menagjimenti që të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve kontigjente në datën e pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e raportuar.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë të shprehura në Euro.

Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël të aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare është paraqitur si më poshtë.

Monedha funksionale dhe raportuese e Kompanisë është Euro që është një monedhë ligjore në tertorin e Kosovës që nga 1 janari 2002.

### **3.1 Të arkëtueshmet tregtare**

Të arkëtueshmet tregtare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionet për dëmtime. Një dispozitë për zhvlerësim të llogarive të arkëtueshme tregtare vendoset kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë e theksuara financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentoj ose riorganizime financiar, dhe mospagesa ose pagesat (më shumë se 30 ditë vonesë) konsiderohen si tregues se të arkëtueshmet tregtare janë zhvlerësuar. Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, skontuar me normën fillestare të interesit efektiv. Asetet me një maturim të shkurtër nuk janë zbritur. Vlera e mbartur e aktivitetit ulet nëpërmjet përdorimit të një llogarie kompensimi, dhe shuma e humbjes është e njohur në llogaritë e fitimit dhe humbjes. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pakthyeshme, shlyhet kundër kontos për lejimet e të arkëtueshmeve tregtare. Arkëtimet pasuese të shumave zbritura më parë njihen si fitim aktuale në pasqyrën e të ardhurave.

### **3.2 Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në bilanc me vlerën e kostos . Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe depozitat e mbajtura në thirrje me bankat lokale.

### **3.3 Huazimet**

Huazimet, i përbërë nga afat-gjatë dhe të shkurtër - kredi afatgjatë dhe afatshkurta mbartin interes nga institucionet financiare vendore dhe palëve të lidhura, janë bartur në të ardhurat e marra, neto e kostove të transaksionit të shkaktuara.

### **3.4 Të pagueshmet tjera**

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera janë matur në kosto e cila është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuar ose të faturuara për kompaninë.

### **3.5 Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat njihen kur është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të rrjedhin në ndërmarrje dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Shitjet neto njihen nga taksat e shitjeve dhe lirime kur dorëzimi ka ndodhur dhe transferimi i rreziqeve dhe i përfitimeve ka përfunduar. Të ardhurat nga shërbimet e pasqyruara njihen duke iu referuar fazës së përfundimit, kur mund të matet me besueshmëri. Faza e kompletimit është përcaktuar duke u bazuar në anketat e punës së kryer.

Shpenzimet operative janë njohur në pasqyrën e të ardhurave në përdorimin e shërbimit ose në datën e origjinës së tyre.

Të ardhura nga interesi dhe shpenzimet raportohen në baza akruale.

### **3.6 Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë**

Tatimi mbi fitimin paraqet shumën e tatimit aktualisht të pagueshëm dhe të shtyrë.

Tatimi i pagueshëm aktualisht llogaritet dhe paguhet në përputhje me Ligjin Nr 05/L-029 të Ardhurat e Korporatave. Tatimi final mbi fitimin në një normë prej 10% janë të pagueshme bazuar në fitimin vjetor të paraqitur në pasqyrën e të ardhurave e rregulluar për zërat, të cilat janë të patatueshëm apo të lejuar. Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet tatimore mund të barten për tu vendosur në shtatë vitet e ardhshme pas vitit në të cilin humbja është paraqitur.

Tatimi i shtyrë i të ardhurave është dhënë në mënyrë të plotë, duke përdorur metodën e detyrimeve, që rrjedhin nga diferencat e përkohshme ndërmjet bazës tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre kontabël në pasqyrat financiare.

### 3.7 Përfitimet e punonjësve

#### *Obligimet e pensionit*

Kompania, në rrjedhën normale të biznesit të tij, kryen pagesa në emër të vet dhe në emër të punonjësve të tij për të kontribuar në pensionet e detyrueshme sipas legjislacionit lokal. Kostot e pësuar në emër të Kompanisë janë ngarkuar në Pasqyrën e të Ardhurave.

### 3.8 Grantet Qeveritare

Grantet nga qeveria njihen në vlerën reale kur ka një siguri të arsyeshme që grantet do të mirren dhe Federata Aeronautike e Kosovës do të përbush kushtet e bashkangjitura. Grantet qeveritare në lidhje me shpenzime janë të shtyera dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën kanë ndodhur shpenzimet për të cilat ka qene i dedikuar granti. Grantet qeveritare në lidhje me blerjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve janë të përfshira në detyrime jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyre dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në baza drejt-vizore sipër jetës së pritur për pasuritë e lidhura.

## FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS

### 4. -PARAJA GATËSHME-

Paraja në Bank	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
NLB –Prishtinë	1,278	334
<b>Totali parave Bank</b>	<b>1,278</b>	<b>334</b>

Paraja e gatëshme në fund të periudhës përbëhet nga pjesa e mbetur e më 31.12.2019 e paras në Banka .Subjekti transaksionet bankare i kryen me (NLB Bank ).

### 5. -LLOGARIT E ARKËTUSHME -

	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
Llogarit e arktushme tregtare	900	0
<b>Totali:</b>	<b>900</b>	<b>0</b>

Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

### 6. – LLOGARIT E ARKËTUSHME NGA GRANTET -

Llogarite arkëtueshme nga Granetet MKRS	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
MKRS	18,564	0
<b>Totali :</b>	<b>18,564</b>	<b>0</b>

**FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS**

**7. –INVESTIME FINANCIARE AFATSHKURTRA -**

	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
Huadhënje afatëshkurtra	0	5,891
<b>Totali:</b>	<b>0</b>	<b>5,891</b>

**8. -LLOGARIT E PAGUSHME-**

<b>Llogarit e pagushme tregtare</b>	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
Perfect Fly-Paraglanding Club	1,095	0
Aeroklub Shkaba	1,020	0
Aeroclub Albania	3,000	0
Independence	5,350	0
Të tjera	2,011	0
<b>Totali :</b>	<b>12,476</b>	<b>0</b>

**9. –DETYRIMET E TATIMIT –**

<b>Përshkrimi</b>	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
Detyrimi i tatimit në fitim	502	0
<b>Gjithsej:</b>	<b>502</b>	<b>0</b>

Përbëhen nga pjesa e papaguar e tatimit në fitim për vitin 2019.

## FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS

### 9a. – DETYRIMET TJERA AFATSHKURTA-

Përshkrimi	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
Huamarrje afatshkurtra	2,035	5,000
<b>Gjithsej:</b>	<b>2,035</b>	<b>5,000</b>

### 10. -TË HYRAT NGA SHITJET

Të hyrat nga shitja	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
Të hyrat nga Ministria e Kulturës	37,128	32,120
Te hyrat nga kuotizimet	2,290	1,025
Të hyrat nga pilotët	2,600	710
Të hyrat nga shkolla e fluturimeve	800	400
Të hyrat nga sponsorizuesi Scardian	-	600
Të hyrat nga shqiponja e artë-shperblimi gares	-	300
<b>Totali I të hyrave</b>	<b>42,818</b>	<b>35,155</b>

Të ardhurat kompania I realizon nga financimi Ministris Kulturës ,Rinisë dhe Sportit sipas memorandumit të bashkëpunimit të lidhur me Federatën Aeronautike të Kosovës në vlerë 37,128 € ,e cila duhet të realizohet në katër kiste gjatë vitit 2019 ,TM1 , TM2 ,TM3 dhe TM4 , nga donacione të tjera dhe të hyra nga aktivitete sportive.

### 11. – SHPENZIMET E ADMINISTRATIVE

Përshkrimi	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
Shpenzimet e pagave	0	1,200
Shpenzimet e auditimit dhe kontabilitetit	1,000	500
Shpenzimet e karburantit	0	3,049
Shpenzimet e përkthimit të statutit Federatës	0	500
<b>Totali:</b>	<b>1,000</b>	<b>5,249</b>

**FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS**

**Shpenzimet programore dhe donacionet**

**Shpenzimet programore dhe donacionet**

	<b>2019</b>
Anetaresimi vjetor ne KOK	200
Anetaresimi vjetor ne FAI	2,830
Memorandumi i bashkepunimit me KK Istog	800
Pagesa e anetaresise vjetore ne APPI per pilotet e FAK (30 pilotë)	1,050
Dekoratat dhe medaljet	694
Medalje dhe Kupa	24
Subvencioni i klubeve per pjesemarrje ne garat e kampionatit kombetar	925
Shpenzimet operative te Federates	808
Trajnime - Ngritja e kapaciteteve profesionale të federatës	2,600
Garat e kampionatit kombetar - organizimi dhe shperblimet	890
Garat kombëtare - paragllajdzëm distancë	2,094
Garat kombëtare - paragllajdzëm precizion	3,744
Garat nderkombetare jashte shtetit - paragllajdzem distance	2,390
Garat nderkombetare jashte shtetit - paragllajdzem precizion	2,736
Garat nderkombetare ne paragllajdzem distance	2,670
Garat nderkombetare ne paragllajdzem precizion	1,151
Femrat - Subvencionimi per pjesemarrje ne garat kombetare	465
Femrat - Trajnimi i piloteve te reja te gjinise femrore	1,800
Trajnime API	3,000
Shfrytëzimi kapaciteteve	5,056
Licensë kombëtare për shfrytëzim të radio frekuen	490
<b>Gjithsej</b>	<b>36,417</b>

	<b>2018</b>
Pagesa e anetaresise	2,652
Shpenzimet e biletave për udhëtime	2,534
Shpenzimet e fjetjes	5,222
Regjistrimi I garave FAI dhe aviacioni civil I Kosovës	375
Shpenzimet e ushqimit për sportista	2,389
Shpenzimet e paisjeve sportive	1,806
Antarësia në komitetin olimpik	200
Shpenzimet e udhëtimit të antarëve të kryesisë	950
Kuotizimi I pjesmarrjes në gara ndërkombtare	2,100
Mirëmbajtja e shpenzimeve të shtëpis malore	480
Ndihma e sportistëve nga garat kombëtare e ndërkombëtare	1,890
Pages për ekzaminimin e licencës	490
Marrja me qira e veturës	1,318
Shpenzimet e garës në Gjirokastër	990
Pagesa për viza Shëngen	120
Çertifikimi I pilotëve	1,280
Pagesa për pjesmarrsit në konferencën e FAI Egjipt	1,300
Pagesa për pastrimin e terenit në gara	150
Shpërblimi për fituesit e garës Suharekë	350
Shpenzimet e marketingut të federatës	390
Rregullimi I veturës për gara në slloveni	237
Trajnimi për fluturime për aeroplan të lehtë	700
Shpenzimet e garave Kosova Open	470
<b>Gjithsej</b>	<b>28,393</b>

**13. – SHPENZIMET E TJERA**

Përshkrimi	2019 Vlera në €	2018 Vlera në €
Shërbimet Bankare	384	283
<b>Totali:</b>	<b>384</b>	<b>283</b>

**14. Tatimi në të ardhura**

Ndërmarrja gjatë vitit afarist ka rezultuar me fitim prej 5,016 dhe ka paguar tatim në vlerë 502 € .

**15. Zotimet dhe kontigjencat**

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhjes së parasë që trupëzon përfitime ekonomike është e largët. Një aset kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë se, një detyrim i pësuar në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

**16. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese**

Menaxhmenti Federata Aeronautike e Kosovës nuk është në dijeni për ngjarjet që kanë ndodhë pas datës së bilancit të gjendjes që mund të ketë ndikim apo kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të saj pas përfundimit të periudhës raportuese.

**17. Transaksionet me palët e lidhura**

Federata Aeronautike e Kosovës nuk ka transaksione me palët e lidhura për të cilat transaksione kërkojnë shpalosje në pasqyra financiare.

**18. Aprovimi i pasqyrave financiare**

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim më 31.03.2020.